

IS THE FIRST  
7-43



VIP  
49-55

Unitron, më afër Shqipërisë  
**Unitron closer to Albania**


66-67

DITËN & NATEN  
**DAY & NIGHT**  
24 orë ngajeta e Stambollit/  
**24 hours of Istanbul life**  
Orientime - Directions 86-87

EKONOMI / **ECONOMY**  
Dritan Prifti: "Ja si do të privatizohen të gjitha objektet shtetërore"  
**Dritan Prifti: "That's how the public assets will be privatized"** 57-65



**LIFESTYLE**  
Sky test  
Turizmi hapsinor  
**Space tourism**  
Depresioni Si ta luftojmë/  
**Depression How to cure it** 88-97



"I huaji" vepër fituese e çmimit të parë në Francë, në konkurrin ndërkombëtar të grafikës humoristike Tourcoing, 2006.

**The Stranger**, first prize in France, at the International Competition of Humoristic Graphics, Tourcoing, 2006

## Në valixhen e **Agim Sulajt**

Mjeti ku futen endrrat, dëshirat, ngacimet dhe emocijet e jetës... nuk është vetëm për rrabat valixha e piktorit dhe e karikaturistit vlonjat

## In Agim Sulaj's suitcase

An object where dreams, wishes, excitements and life emotions are put... the suitcase of Agim Sulaj, painter and caricaturist from Vlora, is not only for clothes

Agim Sulaj


# Në valixhen e

Mjeti ku futen ëndrrat, dëshirat, ngacmimet dhe emocionet e jetës... nuk është vetëm përrrobat valixha e piktorit dhe e karikaturistit vlonjat Agim Sulaj.

Nga Lola Rrapaj

**V**lera e saj për karikaturistin e njohur shqiptar gjallërohet vetëm në qill, gjatë udhëtimeve. Me të ka fituar shumë çmime ndërkombe të nre zhanrin e karikaturës. Jo rrallëherë, valixha ka qenë pjesë e veprave të tij, sidomos në kontekstin e emigrantit. Si model i ka shërbyer ngaherë një valixhe e vogël, të cilën e ruan si një objekt të vyer të krijimtarisë së tij artistike.

E vjetër dhe e punuar në lëkurë, për Agimin ajo mbetet "modelja e ëndrrave të emigrimit". Është e para që e mbajti me vete dhe ku i ruajti dëshirat deri në realizim. Kujton me detaje kur e bleu atë në Greqi, në vitin 1991. Atëherë, Bashkia e Janinës përuroi hyrjen e pikturës së tij, "Koka e Ali Pashait te Sulltani", në Muzeun e Aliut në Ishull. Ishte e markës samsonite. Me blerjen e saj, i lindi edhe dëshira për t'u nisur nga Shqipërisë, një largim jo përgjithnjë, por për t'u prezantuar me të panjohurën, për t'i dhënë impuls krijimit, për t'u formuar e për të qenë më në fund Agim Sulaj, artist i vlerësuar edhe përtotku kufijve. Piktori kujton se shumë gjëra para hapjes së kufijve i kanë ardhur si "zëra mesazhere" përrugën që e priste. Jo më kot në Turqi, para largimit, u shpall fitues i një konkursi ballkanik zhvilluar po në Greqi, me veprën e titulluar "Shtëpia e emigrantit"... Ja një bindje më shumë "për ta blerë" valixhen samsonite dhe për të ndjekur më në fund sinjalët e çmimeve të para tej Shqipërisë. "Atëherë, ato ishin përmua si xixellonja që po më udhëhiqin në një botë magjike, ku nuk flitej më shqip dhe ku kishte drita e ujë 24 orë", - thotë Agimi. E kujton si tani se çfarë vendosi brenda saj. Iшин veshje të zakonshme: një këmishë me pika, pantallona xhins "dhe një hudhëri diku në kanotiere, si shenja e fundit e një bote që po e lija", - vijon bisedën piktori. Po nuk mungonin as vizatimet e publikuara te revista "Hosteri", publikime të punëve gjatë periudhës së komunitetit, një sapun "Drita", një furçë dhëmbësh e mbështjellë me gazetën "Bashkimi" apo "Zëri i Popullit" - kjo nuk i kujtohet mirë - disa tablo në miniaturë, si dhe një laps me gomë rozë (markë kineze)... Megjithatë, një gjë e kujton mjaft mirë, valixhen e tij të ikjes, ku mbante shumë ëndrra,



krejtësisht të padukshme për kontrollet e doganierëve. Ishte valixha e vogël si një shtëpi e re, por që mbante atë aromën e çuditshme të një bote të cilën njerëzit e quanin emigrim. Atëherë ishte viti 1995. Që nga ajo kohë u vendos në Itali, ndërsa aktiviteti i tij artistik i ka kaluar edhe kufijtë e vendit mikpritës, veçanërisht me karikaturën. Artisti shqiptar po kalon një moment të artë në këtë zhanër: ftesa, konkurrime e çmime njëri pas tjetrit. Shumë sende kanë ndryshuar edhe në valixhen e tij. Objektet që sot merr me vete, udhëtim pas udhëtimi, mbeten kryesisht më thelbësoret: pantallona e golf të zi, një këmishë të bardhë e një kravatë. "Gardëroba ime është "e varfëri". Përdor shpesh ngjyrën e zezë e të bardhën, si në dimër ashtu edhe në verë. Veshja ime është gati-gati një "uniformë piktorike", me të cilën ndihem mirë", - vijon artisti. Në valixhe nuk mungon asnjëherë edhe dosja ngjyrë vishnjë plot me letra të bardha e një laps me majë të mprehtë. "Aty unë vizatoj ngacmimet e impresione nga udhëtimi, detaje profilesh e tipash, ide të çastit, vizatime të shpejta dhe thelbësore", - thotë Agimi për dosjen që e quan tashmë si një mik besnik të orëve të pritjes nëpër aeroporte. Edhe arsyja, për të cilën merr rrujan e largimit ka ndryshuar. Tani gjithçka ka të bëjë me ftesa të ndryshme nga organizatorë konkursesh ndërkombe të përkarakatura, për ceremoni çmimesh apo për ndonjë ftesë për të qenë anëtar në juritë e konkurseve.

## UDHËTIMET

"Janë të gjitha udhëtime që nuk zgjasin më shumë se pesë ditë, ndaj edhe jam mësuar të përgatis për të marrë me vete më të domosdoshmet e objekteve, pa harruar asnjëherë beretën e zezë, kapelën që e identifikon ndër të tjerë, beretën e kujtesës, por edhe të veprimitari të artistike. Janë gjithnjë emocionuese udhëtimet me avion për artistin.

Ato nisin gjithnjë me një moment pasigurie për të. Por është vetëm një çast, ai i shkëputjes nga toka e më pas gjithçka për të është e qetë.

Duke qeshur shton se stjuardesat më simpatike janë shqiptaret. Më pas nis pëershkrimin përgjithçka vështron nga dritarja. E vesh atë me detaje ngjyrash që ua rrëmben piktureve të tij dhe të thotë se toka e parë nga lart të kujton veshjet ushtarake; ajo ngjan me një rrjetë pafund, në një qill plot drithë... Kështu, parë prejreve, gjithçka merr tjetër kuptim. Në mënyrë simbolike, valixha e emigrantit e ka shoqëruar edhe në pikturnat e tij. Si artist, e njohu më parë botën jashtë. Kur në Shqipëri ishte ende izolimi i diktaturës, Sulaj kishte provuar të ekspononte jashtë vendit.



**Vepra**  
"Immigration",  
fituese e çmimit  
Grand Prix, Itali  
2009.

**The work**  
**Immigration**,  
winner of Grand  
Prix Prize, Italy  
2009



**Dosja** me fletë e  
kartolina spirit.

**The file** with  
humorous sheets  
and postcards



## Agim Sulaj's Suitcase

An object where dreams, wishes, excitements and life emotions are put... the suitcase of Agim Sulaj, painter and caricaturist from Vlora, is not only for clothes.

By Lola Rrapaj

According to the famous Albanian caricaturist, it becomes valuable only when in flight, during traveling. He has won many international caricature prizes with it. The suitcase has been often a part of his works, especially in an emigrant's context. His sample has always been a little suitcase which he still preserves today as a precious artistic object of his activity. It's old, leather-covered, but for Agim it remains "the model of emigration dreams". It's the first he took with him and kept his wishes till they fulfilled. He recalls every detail of the day when he bought it in Greece, in 1991. At the time, the Ioannina City Hall inaugurated the including of his painting "Head of Ali Pasha to the Sultan" at Ali Pasha Museum in the Island. It was "Samsonite". After buying it, he had the desire to leave Albania, not forever, but to

introduce with the unknown, to make his creation breathe, to realize himself and to be at last Agim Sulaj, an appraised artist abroad as well. He recalls that before the falling of communism, he had "callings" of what future had in store for him. That's the reason why he won a Balkan competition in Greece again, with a work called "The house of the emigrant"... That's a sign in more to "buy" a "Samsonite" suitcase and to chase at last the signals of prizes abroad. "At that time, they were for me like fireflies leading me to a magic world, where no more Albanian language was spoken and where there was water and electricity 24 hours a day", Agim says. He recalls perfectly what he put in it. Usual clothes, a spotted chemise, jeans, and a garlic somewhere between the vest, as the last and ultimate sign of a world I was leaving behind", he continues. But also there were different designs published at "Hosteni" review, publishing of his work during communism, a "Drita" soap, a toothbrush enclosed with a newspaper, "Bashkimi" or "Zeri i Popullit", he doesn't remember, some miniatures, and a pencil with pink rubber (Chinese)... nevertheless, it's one thing he remembers: his goodbye suitcase had many dreams within, totally invisible for customs officers. It as the suitcase as a new home and it had the odd smell of a new world people called emigration. It was 1995. By that time he settled in Italy, while his artistic activity went beyond the borders of the hosting country. Especially with the caricature. The Albanian artist is having a golden time in this genre, invitations, competitions and prizes in row. He has changed a lot of things even in his suitcase. The objects he's taking during travelling are the most essentials: pants and a black pullover, a white shirt and a necktie. "My wardrobe is "poor". I usually use the white and black colors, in winter and summer as well. My clothing is quite a "pictorial uniform" I just feel fine with", says the artist. In his suitcase never fails to be a dark red file full of white letter and a sharpened pencil. "It's there I draw impressions and impulse from my travels, profile and type details, instant ideas, fast and essential drawings", says Agim for the file that he already considers as a faithful friend during his transits in airports. Even the reason why he leaves now has changed. Now everything concerns important invitations from international caricature competition organizers, for ceremonies or an invitation to be part of some juries in competitions.

### TRAVELS

"They all are travels not more than five days, thus I'm used to take with me the most essential stuff, never forgetting my black beret... the hat identifying him among others, the beret of memories, but of artistic creativity as well. For the artist, the flights are always exiting. They always have though a moment of uncertainty. But it's just a moment, the one when the airplane detaches from ground and that's all. He says smiling that the Albanian stewardesses are the most beautiful. After he begins to describe everything he looks out of window. He enfolds it with colorful details and says that the land seen from above reminds him the military vests; it seems like an infinite web in a sky full of light... Thus, seen from the clouds, everything has another sense. Symbolically, the emigrant's suitcase accompanied him even in his paintings. As an artist he acquainted the world before. When Albania still suffered the dictatorship, Sulaj tried to exhibit abroad.



**Libri me karikatura mbi**  
**Shqipërinë e monizmit**  
do t'i dhurohet kryetarit të jurisë, Pol Leurs

**The caricatures book**  
**on Communist Albania**  
intended as a gift for the chairman of the jury,  
Pol Leurs

